



Lajmet e Fundit:

Durrës – Ndëshkohen me masë administrative 2 pronarë subjektesh që u konstatuan të hapur pas orarit të përcaktuar për mbyllje



Lajmet Operacionet

18/06/2021

Fier – Finalizohet një tjetër operacion për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Finalizohet një tjetër operacion për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve.

Operacioni policor i koduar “Vreshtas”, i zhvilluar nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve në DVP Fier.

Sekuestrohen fara kanabisi, lëndë narkotike cannabis sativa, fidanë narkotikë dhe një armë gjahu karabinë.

Vihet në pranga autori i kësaj veprimtarie kriminale.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Fier, në vijim të punës për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe goditjeve kundër aktivitetit kriminal në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë policore, bënë të mundur finalizimin me sukses të operacionit policor të koduar “Vreshtas”.

Në kuadër të këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi M. Xh., 42 vjeç, banues në Cakran.

Arrestimi i këtij shtetasi u bë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në territorin e banesës, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 56.3 kg lëndë narkotike cannabis sativa, 2785 fara kanabisi, fidanë të dyshuar cannabis sativa të kultivuar në vazo lulesh, 1 armë gjahu karabinë, sende që shërbejnë për kultivimin e bimëve narkotike dhe 2 aparate celularë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Fier për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i lëndëve narkotike”, “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.

Share Share Share Share Email

◀ Raporti ditor i ngjarjeve, Policia e Shtetit, 18 qershor 2021

DVP Berat – Organizonte lojëra fati nëpërmjet celularit, procedohet penalisht 1 shtetas. Procedohen penalisht dhe 2 shtetas të tjerë, për vepra të ndryshme penale ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent